

A close-up photograph of a hand holding a white rectangular card. The card features the atrc logo in red and black, followed by the text 'Advocacy Training & Resource Center'. Below this, the title 'RAPORTI VJETOR 2011' is written in red, and 'ANNUAL REPORT 2011' is written in yellow. The background is a blurred image of a person in a blue suit and tie.

atrc.

Advocacy Training & Resource Center

RAPORTI VJETOR 2011

ANNUAL REPORT 2011

RAPORTI VJETOR 2011

PËRMBAJTJA

Përmbajtja

Letër nga Drejtori Ekzekutiv	3
Për ATRC	4
Misioni	5
Partnerët	6
Përkrahësit	7
Programi për Ngritje Kapacitetesh	8
Konsulentat individuale	9
Programi për menaxhim të granteve	10
Programi për avokim	11
Monitorimi i procesit të kthimit të zhvendosurve nga vendet e treta	12
Lëvizja Regjionale për Mjedis “BELLS”	13
Zgjidhja e Konfliktit Social	14
Ambasadorët e Vegjël në Mbrojtje të Mjedisit	15
Praktika te suksesshme - komuna funksionale	16
Drejtesia dhe Qytetarët	17
Synergy për ndërgjegjësimin në SEE	18
Procesi për regjistrimin e popullsis, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë	19
Reforma Zgjedhore 2011	19
Fuqizimi i rolit të rinjëve në skenën politike në Kosovë	20
Zgjerimi i BE-së, transformimi i sektorit të mjedisit dhe energjisë në Kosovë roli i shoqerise civile. 21	
Perceptimii barazis gjinore në 8 komuna të Kosovës	22
ATRC certifikohet nga Ministria e Drejtesis dhe USAID	23
ATRC anëtare e grupeve punuese	24
Programi për informim, Shtypi për ATRC-në	25
Raporti Financiar	26
Botimet e ATRC-së	27
Bordi i ATRC-së	28
Stafi i ATRC-së	28

LETËR NGA DREJTORI EKZEKUTIV

Përshëndetje të nderuar miq,

Sikundër është kthyer në traditë, çdo vit ATRC vjen tek ju me përmbledhjen e punës së saj vjetore, duke synuar që përmes tij të komunikoj me ju dhe njëkohësisht t' ju informoj lidhur me zhvillimet, aktivitetet, projektet dhe rezultatet e arrira brenda vitit raportues.

Viti 2010 ka shënuar disa zhvillime të rëndësishme për ATRC, ndër të cilat mund të përmendim ruajtjen dhe avancimin e partneriteteve me organizata vendore dhe ndërkombëtare, zhvillimin e aktiviteteve bazuar në katër programet bazë të saj: Programi i Administrimit të Grantëve, Programi i Ngritjes së Kapaciteteve, Programi i Avokimit dhe Programi i Informimit, duke siguruar dhe garantuar në të njëjtën kohë përmbushjen e rolit dhe misionit të saj si Qendër e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim.

Aktivitetet e organizuara në njërën anë si dhe rezultatet e arritura në anën tjetër dëshmojnë më së miri për përkushtimin dhe angazhimet e stafit të ATRC-së në përmbushjen e obligimeve që dalin nga misioni i saj si dhe ndihmën dhe përkrahjen e vazhdueshme dhe të pakursyer të ofruar nga partnerët e saj në terren, si OJQ, institucione lokale, ekspertë lokal, media etj.

ATRC, edhe më tej, do të angazhoj të gjitha kapacitetet e saj, që në përputhje me objektivat e katër programeve bazë, të ndihmoj dhe përkrah organizatat joqeveritare në Kosovë; të forcoj kapacitetet e brendshme të organizatave joqeveritare; të avokoj në institucione lokale dhe nacionale për çështje të interesit të përgjithshëm, të vazhdoj të ruaj dhe forcoj edhe më tej rolin e saj të ndërmjetësimit në mes sektorit të OJQ-ve dhe donatorëve të ndryshëm, duke u bazuar gjithmonë në moton kryesore: "Bringing out the advocate in everyone"

Kushtrim Kaloshi
Drejtore Ekzekutive



PËR ATRC

Që nga themelimi i saj në vitin 2001, ATRC ka ndihmuar OJQ-të Kosovare në profesionalizimin e punës së tyre, artikullimin e kërkesave të tyre dhe ka avokuar tek strukturat qeveritare për çështje me rëndësi për shoqërinë Kosovare.

ATRC realizon qëllimet e veta përmes katër programeve kryesore të saj:

1. Programi i ngritjes së kapaciteteve, i cili synon që përmes trajnimeve dhe ofrimit të konsulencave, të ngris kapacitetet e organizatave joqeveritare në Kosovë në fushën e zhvillimit organizativ, menaxhimit të projekteve dhe në avokim.

2. Programi i administrimit të Granteve, i cili synon të ndihmoj organizatat joqeveritare lokale përmes granteve, duke synuar ndryshime të politikave publike, inicim të ligjeve dhe rregulloreve, praktika të reja në të mirë të publikut, fushata edukimi dhe sensibilizimi për çështje të ndryshme si: mjedisi, të drejtat e pakicave, transparenca dhe llogaridhënia etj.

3. Programi për Avokim- ATRC në partneritet me

organizata tjera në vazhdimësi inicion fushata avokimi në nivel lokal dhe nacional, duke synuar që problemet e indentifikuara në komunitet t'i kthej në çështje të forta avokimi dhe si rezultat t'i gjej zgjidhjen e merituar.

4. Programi për Informim, mbështet shkëmbimin e informatave ndërmjet OJQ-ve, institucioneve qeveritare, donatorëve, zyrtarëve dhe qytetarëve. Këtë e realizon përmes diskutimeve publike, konferencave, prezantimeve të donatorëve, publikimeve dhe uebfaqes së ATRC-së.

ATRC beson se ndërtimi i koalicioneve dhe partnerteteve ndërsektorale janë shtylla kyçe për arritjen e qëllimit dhe përmbushjen e misionit të saj. Për këtë arsye, ATRC është në bashkëpunim të vazhdueshëm me OJQ të shumta në Kosovë, është pjesë e fushatave avokuese që kanë për qëllim zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje si dhe është pjesë e rrjeteve në nivel lokal, regjional e ndërkombëtar.



MISIONI

Qendra e Trajimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) është organizatë jofitimprurëse Kosovare e cila angazhohet për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendim-marrje, si kusht për një shoqëri të zhvilluar demokratike dhe stabile rajonale.

ATRC ndihmon në forcimin e rolit të OJQ-ve si agjent të ndryshimit në shoqëri, ngritë kapacitetin e OJQ-

ve dhe iniciativave qytetare që të ndërrmarin fushata avokimi dhe kontribuon në krijimin e institucioneve qeverisëse bazuar ne standardet ndërkombëtare.

ATRC punon me përfaqësues të OJQ-ve, iniciativat qytetare, administratën publike dhe me institucionet politike pa dallim feje, gjinie, etnie, moshe, aftësie, përkatësie politike dhe orientimi seksual.

PARTNERËT

Gjatë vitit 2011 ATRC ka vazhduar bashkëpunimin me organizata e institucione të ndryshme qeveritare në nivele lokale dhe nacionale, me organizata joqeveritare Kosovare dhe ndërkombëtare, në inicimin dhe implementimin e projekteve të përbashkëta.

Institucionet dhe agjencitë qeveritare me të cilat ATRC ka bashkëpunuar gjatë vitit 2011:

34 Komuna të Kosovës: Komuna e Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Gjakovës, Mitrovicës, Gjilanit, Istogut, Skenderajt, Drenasit, Suharekës, Klinës, Rahovecit, Deçanit, Malishevës, Shtimes, Junikut, Ferizajit, Mamushës, Dragashit, Vitisë, Hanit të Elezit, Lipjanit, Kaçanikut, Kamenicës, Vushtrrisë, Fushë Kosovës, Podujevës, Obiliqit, Klllokotit, Novobërdës, Ranillugut, Graçanicës, Shtërpces dhe Parteshit.

60 Shkolla fillore të 30 komunave të Kosovës

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)

Zyra e Prokurorit Disiplinor (KPD)

Inspektoriati Policor i Kosovës (IPK)

Policia e Kosovës (PK)

Gjykatat e Qarkut dhe Gjykatat Komunale të 20 Komunave të Kosovës

Zyret regionale të DMNV-së (Divizionit për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave)

Komisioni për ndërmjetësim pranë Ministrisë së Drejtësisë

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapsinor

Agjensioni për mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Enti i Statistikave të Kosovës

Organizatrat joqeveritare rajonale me të cilat ATRC ka bashkëpunuar gjatë vitit 2011:

The Euclid Network

4x4x4 Balkan Bridges - Shkup

Urban Research Institute - Tiranë

Center for Ecology in Energy – Tuzëll

Green Home – Podgoricë

Environment Ambassadors – Beograd

Center for Modern Skills – Beograd

Environment Forum - EF

Organizatrat Joqeveritare lokale me të cilat ATRC ka bashkëpunuar gjatë vitit 2011:

Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD) Prishtinë

Shoqëria e avokatëve “Sejdiu & Qerkini,” sh.p.k.- Prishtinë

Oda e Avokatëve (OAK) - Prishtinë

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)-Prishtinë

Rrjeti i Gazetarisë Hulumtuese në Kosovë (BIRN)- Prishtinë

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) – Prishtinë/Prizren

Syri i Vizionit- Pejë

Civil Rights Program in Kosovo (CRP/K)-Prishtinë

Internews Kosova- Prishtinë

Qendra Juridike e Kosovës (KLC)- Prishtinë

Rrjeti Rinor i Kosovës (KYN)- Prishtinë

Qendra për Politika dhe Avokim (QPA) - Prishtinë

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF)- Prishtinë

Qendra për Zhvillim të Shoqërisë Civile (CCSD)- Mitrovicë

Komunikimi për Zhvillim Social (CSD) - Graçanicë

Future without fear (FWF)- Shëtrpce

Arnika - Pejë

Integrimi dhe përparimi i shoqërisë – Skenderaj

Proactive - Kamenicë

Ekovision – Podujevë

AKT - Prizren

Këshilli i Prindërve dhe Arsimtarëve - Malishevë

Shoqata Intelektuale Pavarur (SHIP)- Deçan

Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Mjedisit (IQMQP) - Prishtinë	AVONET- Ferizaj
Qendra rinore (AKT) – Fushë Kosovë	Bethany Christian Services (BCS) - Gjakovë
Media Opinion - Rahovec	Klubi për politikë të jashtme (KPJ)- Prishtinë
Elita – Viti	Handikap Kosova – Prishtinë
Agro Eco – Gjilan	Futura Plus - Shëtrpce
Iniciativa Qytetare - Obiliq	World of Angels - Mitrovicë
Organizata për persona me aftësi të kufizuar (OON)– Gracanicë	Me dorë në zemër – Mitrovicë
SPERANZA – Mitrovicë	Shoqata e Gruas - Gjakovë
Asociacioni i të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut (YAHR)- Lipjan	Shoqata e të Verbërve dhe atyre me të Pamë të Dobësuar të Kosovës (ShVPDK)– Prishtinë
Qendra Rinore - Prishtinë	Liria – Istog
	Eko-Sharri – Shëtrpce

PËRKRAHËSIT

Përkrahësit e ATRC-së gjatë vitit 2011 në implementimin e projekteve të saj kanë qenë:

Agjensioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) <http://www.usaid.gov/kosovo>
 Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (ISC/USAID) <http://www.iscvt.org>
 Academy for Educational Development (AED/USAID) <http://www.aed.org>
 Grupi i së Drejtës dhe Politikave Ndërkombëtare Publike (PILPG) www.justiceandthepeople.org
 Agjensioni i Suedisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) www.sida.se
 Qendra Ndërkombëtare Olof Palme www.palmecenter.org
 Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë <http://pristina.usembassy.gov>
 Ambasada e Holandës <http://www.nlembassy.org.yu>
 Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) <http://www.unhcr.org>
 FRIEDRICH EBERT STIFTUNG - FES www.fes-prishtina.org
 UNOPS www.unops.org
 Forum Syd Kosovo Programme www.kosovo.forumsyd.org
 Swiss-Kosovo Local Governance and Decentralization Support - LOGOS <http://www.intercoopkos.org>
 Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSBE) www.osce.org
 Care international Kosova <http://www.careks.org>



PROGRAMI PËR TRAJNIME DHE NGRITJE KAPACITETESH

Ky program ka për qëllim t'ju ofroj OJQ-ve metodat dhe mjetet e duhura për të iniciuar ndryshime në komunitetet e tyre. Dita ditës këto organizata ballafaqohen me sfida të reja dhe nevojat e tyre nuk janë të njëjta si më parë, andaj edhe ATRC në vazhdimësi ndryshon programin e saj duke prezantuar trajnime më të avan-


cuara dhe me tema të reja, në mënyrë që nevojat e përfituesve të saj të reflektohen në këtë program. Këtë vit ATRC ka zhvilluar edhe dy module të reja trajnimi: Barazia gjinore dhe Planifikimi i projekteve në komunitet.

Gjatë vitit 2011, trajnerët e ATRC-së, në kuadër të projekteve, kanë realizuar 24 trajnime dhe punëtori, nga të cilat kanë përfituar OJQ dhe institucione të ndryshme. Gjithashtu, ATRC ka realizuar edhe 18 trajnime në përputhje me kërkesat e Forum Syd Kosovo Programme, Intercooperation, Komisionit për ndërmjetësim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Care International Kosovo dhe OSBE.

Temat e përfshira në Programin e trajnimeve:

- Dizajnimi i Projekt Propozimit
- Menaxhimi i Ciklit të Projektit
- Menaxhimi i OJQ-ve dhe Ngritja e fondeve
- Avokimi dhe Ndërtimi i Koalicioneve
- Roli i OJQ-ve në Shoqërinë Civile
- Qeverisja e Mirë
- Lidërshipi dhe Menaxhimi
- Planifikimi Strategjik
- Analiza e Kostove

- Monitorimi dhe Vlerësimi
- Marrëdhëniet Ndërmjet OJQ-ve dhe Mediave
- Komunikimi Efektiv
- Komunikimi me Klient
- Menaxhimi Bazik Financiar
- Marrëdhëniet me Publikun dhe Marketingu
- Menaxhimi i Konfliktëve
- Negociatat
- Qeverisja me Pjesëmarrje
- Planifikimi Kooperues
- Buxhetimi me Pjesëmarrje
- Infrastruktura ligjore që reflekton punën e komunave në Kosovë
- Mekanizmat e përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse
- Funksionimi i qeverisë lokale
- Planifikimi i projekteve në komunitet
- Barazia gjinore



KONSULENCAT INDIVIDUALE

Ndryshe nga trajnimet formale të cilat u dedikohen një audience më të madhe, konsulencat janë të dizajnuara për të adresuar nevojat specifike të individëve dhe organizatave në mënyrë të veçantë. Për këtë arsye, ATRC praktikon metodën e kombinimit të dy shërëbimeve: trajnimet me konsulencat individuale, duke synuar të përmbush sa më mirë nevojat e çdo përfutuesi dhe njëkohësisht për të ngritur efektivitetin e programit të saj.

Gjatë vitit 2011, janë zhvilluar 42 konsulencat individuale në çështje që kanë të bëjnë me shkrim të projekt propozimeve, zhvillim organizativ, menaxhim financiar, ngritje të fondeve, zgjidhje konflikti, ndërmjetësim etj.

PROGRAMI PËR MENAXHIM TË GRANTEVE

Në kuadër të projektit për Fuqizim të Shoqërisë Civile në Kosovë, të menaxhuar nga ISC përmes fondeve të USAID, ATRC së bashku me tri organizatat partnere të saj: Qendrën për Zhvillim të Shoqërisë Civile (CCSD) në Mitrovicë, Komunikimi për Zhvillim Social (CSD) në Gracanicë dhe Ardhmëria pa Frikë (FWF) në Shtërpce në prill të këtij viti kanë përfunduar procesin e administrimit të granteve, të cilat janë ndarë për 18 OJQ-të kosovare.

Projektet janë përqëndruar kryesisht në fushata avokimi në nivele lokale, duke synuar ndryshime të politikave publike, inicim të rregulloreve të reja lokale, praktika të reja komunale në të mirë të publikut, fushata edukimi dhe sensibilizimi për çështje të ndryshme si: transparenca, llogaridhënia, mjedisi, të drejtat e pakicave etj.

Pasqyra e projekteve të shpërblyera me grante:

Bethany Christian Services (BSC) – Gjakovë

Pjesëmarrja e komunitetit RAE në implementimin e strategjisë për vitet 2009-2015

FORTESA – Kamenicë

Komunikimi mes qeverisë lokale dhe qytetarëve, nëpërmjet këshillave lokal

Shoqata e të Verbërve dhe atyre me të Pamë të Dobësuar të Kosovës - Prishtinë

E drejta për qasje të lirë

Liria - Istog

Ngrite zërin

Shoqata e Personave me Paralizë të Fëmijëve, Handikap Kosova - Prishtinë

Monitorimi i implementimit të planit nacional të veprimit për persona me aftësi të kufizuara

Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Qytetit të Prishtinës (IQMQP) - Prishtinë

Fushatë preventive kundër degradimit të qytetit të Prishtinës

ELITA - Viti

Komuna në shërbim të qytetarëve

CDKD

Mbrojeni Natyrën dhe Natyra do t'ju mbroj juve

Aksioni kundër dhunës dhe ndërtimi i paqes (ANP) - Gjilan

Eja të ndryshojmë diçka

Organizata për persona me aftësi të kufizuara (OON)-Gracanicë

Asgjë mos bëni për ne, pa ne

SPERANZA -Mitrovicë

Fushatë avokimi për ngritjen e kapaciteteve dhe punësimin e rasteve sociale

Asociacioni i të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut (YAHR) - Lipjan

Krijimi i mekanizmave për pjesëmarrje të komuniteteve të fshatrave në komunën e Lipjanit

Futura Plus – Shtërpce

Zyra shërbyese për qytetarë

World of Angels - Mitrovicë

Ne kemi të drejtë për punë

Klubi për politikë të jashtme - Prishtinë

Kosova në internet

Me dorë në zemër - Mitrovicë

Pjesëmarrja aktive e qytetarëve, në procesin vendimmarrës në nivelin komunal ndikon në qeverisjen e mirë

Shoqata e Gruas – Gjakovë

Përpilimi i “Rregullores për Eko – Taksat “ në Komunën e Gjakovës



PROGRAMI PËR AVOKIM

Për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në zhvillimin e institucioneve dhe praktikave demokratike, ATRC në partneritet me organizata tjera dhe e vetme, në vazhdimësi inicion fushata avokimi në nivel lokal dhe nacional, duke synuar që problemet e indentifikuara në komunitet t'i kthej në çështje të forta avokimi dhe si rezultat t'i gjej zgjidhjen e merituar. Programi për avokim gjithashtu siguron një platformë për rrjetëzim, shkëmbim informatash dhe aktivizim me OJQ-të tjera nga Kosova dhe rajoni.

Gjatë vitit 2011, ATRC ka qenë e përfshirë në këto projekte:

- Zgjidhja e Konfliktit Social
- Drejtësia dhe qytetarët
- Monitorimi i procesit të kthimit të zhvendosurve nga vendet e treta
- Lëvizja regjionale për ambient BELLS
- Ambasadorët e Rinj në Mbrojtje të Mjedisit
- Praktika te suksesshme -komuna funksionale
- Synergy for Energy Awareness in SEE
- Procesi i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë
- Fuqizimi i rolit të të rinjëve në skenën politike në Kosovë
- Reforma Zgjedhore 2011
- Zgjerimi i BE-së, transformimi i sektorit të mjedisit dhe energjisë në Kosovë- Roli i Shoqërisë Civile
- Perceptimi i Barazisë gjinore në 8 Komuna të Kosovës



MONITORIMI I PROCESIT TË KTHIMIT TË ZHVENDOSURVE NGA VENDET E TRETA

Gjatë vitit 2011, ATRC vazhdoi implementimin e projektit “Monitorimi i procesit të kthimit të të zhvendosurve nga Vendet e treta”, i cili financohet nga UNHCR. Projekti ka si objektiv monitorimin e procesit të kthimit të detyruar dhe vullnetar të azil kërkuesve Kosovar nga vendet e treta në Kosovë.

Përmes këtij projekti, ekipi monitorues i ATRC-së arrin të identifikoj të gjitha rastet, të cilat janë kthyer në mënyrë të detyruar apo vullnetare, duke përcjellur në vazhdimësi trendet e të kthyerve në Kosovë dhe qëndrueshmërinë e këtyre kthimeve.

Ekipi i monitoruesve të ATRC gjatë vitit 2011 është vizituar nga përfaqësuesit e zyrës së UNHCR, të cilët shprehën interesin e tyre në lidhje me punën dhe angazhimet e stafit të ATRC-së në monitorimin e procesit të kthimit të zhvendosurve në përgjithësi dhe angazhimet dhe përkujdesja që personat e kthyer marrin nga institucionet relevante pas kthimit në Kosovë -në veçanti.

LËVIZJA REGJIONALE PËR MJEDIS "BELLS"



ATRC në rolin e partnerit implementues për Kosovë të Lëvizjes Rajonale Mjedisore BELLS ka vazhduar implementimin e projektit Regional Environmental Advocacy/REA Action and Cohesion in Western Balkans), i përkrahur nga Ambasada Mbretërore e Holandës.

Projekti ka synuar ngritjen e vetëdijes të vendim-marrësve dhe akterëve të tjerë me rëndësi, për nevojën e përmirësimit të legjislacionit për ambient, vënien e çështjes së mjedisit në krye të agjendave qeveritare si dhe zhvillimin e fushatave avokuese për inicim të politikave publike, ligje, vendime, praktika dhe procedura, të cilat do të krijonin përmirësim të mjedisit në nivele nacionale dhe rajonale.

Në kuadër të projektit këtë vit në Budva të Malit të Zi është organizuar edhe konferenca rajonale e rrjetit BELLS me temën: Implementimi i legjislacionit lokal mjedisor si dhe harmonizimi i tij me standardet e BE-së.

Përveç koordinatoreve regional të BELLS nga gjashtë shtetet anëtare të kësaj Lëvizjeje, në konferencë morën pjesë edhe përfaqësues nga komunat e gjashtë shteteve anëtare të BELLS, si: Kosova, Maqedonia,

Mali i Zi, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia.

Nga Kosova në këtë takim morën pjesë nënkryetari i komunës së Prishtinës z. Abdullah Hoti, kryetari i komunës së Obiliqit z. Mehmet Krasniqi, anëtar i Bordit regional të BELLS z. Isa Elezaj si dhe drejtori i ATRC z. Kushtrim Kaloshi.

Përmes prezantimeve të përgatitura, pjesëmarrësit nga komunat e shteteve të regjionit prezantuan shembuj dhe praktika të suksesshme në implementimin e legjislacionit lokal mjedisor, duke synuar që këto praktika dhe shembuj suksesi të merren dhe dyfishohen edhe në komunat tjera të shteteve tjera.

Partnerët implementues të Lëvizjes Rajonale Mjedisore BELLS:

ATRC – Kosovë
Instituti për Hulumtime Urbane URI - Tiranë
Qendra për Ekologji dhe Energji - Tuzël
4x4x4 Urat Ballkanike -Shkup
Shtëpia e Gjelbër - Podgoricë
Qendra për Aftësi Moderne - Beograd



ZGJIDHJA E KONFLIKTIT SOCIAL

Te pestin vit me radhë ATRC vazhdoi implementimin e projektit Zgjidhja e konfliktit social, i financuar nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme. Projekti kishte për qëllim t'i ndihmoj qeverisë lokale dhe shoqërisë civile të nxis dhe fuqizoj marrëdhëniet në mes tyre në mënyrë që të parashikoj dhe t'i përgjigjet më mirë nevojave të komunitetit.

Këtë vit projekti është fokusuar në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal dhe përfaqësuesve të

shoqërisë civile për aplikimin e buxhetimit me pjesëmarrje, si një mekanizëm që ju mundëson qytetarëve të jenë pjesë e vendimmarrjes që nga faza e planifikimit të buxhetit komunal dhe deri në implementimin e tij. Projekti është implementuar në 11 komuna të Kosovës: Prizren, Gjakovë, Pejë, Klinë, Istog, Deçan, Junik, Suharekë, Rahovec, Malishevë dhe Dragash.

Gjatë këtij viti ATRC realizoi 11 trajnime dy ditore me temë “Buxhetimi me pjesëmarrje”, për anëtarët e Kuvendeve Komunale, përfaqësuesit e Shoqërisë Civile dhe zyrtarët komunal të 11 komunave, duke vazhduar më pas me organizimin e 3 punëtorive të përbashkëta me po këtë temë.

Gjatë këtyre punëtorive pjesëmarrësit diskutuan dhe dhanë rekomandime rreth hapave që duhet të ndërmerren komunat me qëllim të aplikimit të buxhetimit me pjesëmarrje. Rekomandimet e dala nga këto punëtori janë përfshirë në publikimin “Udhëzime për procesin e buxhetimit me pjesëmarrje”, i cili u është shpërndarë falas zyrtarëve komunal dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Me qëllim të prezantimit të këtij ud-

hëzuesi ATRC në vazhdim organizoi konferencën me të gjithë akterët e përfshirë në projekt, si dhe një konferencë për media në Prizren. Udhëuesi për buxhetimin me pjesëmarrje mund të shkarkohet nga web faja e ATRC-së www.advocacy-center.org.

Përmes këtyre aktiviteteve, ATRC ka synuar që të rris bashkëpunimin në mes zyrtarëve komunal dhe shoqërisë civile, të ushtroj presion demokratik në institucionet lokale për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje si dhe t'u ndihmoj institucioneve lokale që në bashkëpunim me qytetarët të identifikojnë dhe prioritetizojnë nevojat dhe rekomandimet e qytetarëve, përmes aplikimit të buxhetimit me pjesëmarrje.



AMBASADORËT E VEGJËL NË MBROJTJE TË MJEDISIT

Projekti Ambasadorët e vegjël në mbrojtje të mjedisit, i financuar nga Ambasada Amerikane në Kosovë, ka synuar ndryshime pozitive në çështje të mjedisit përmes aftësisimit të nxënësve të klasëve të pesta të shkollave fillore. Me qëllim të vetëdijësisimit dhe inspirimit të gjeneratave të reja për të qenë të përkushtuar ndaj mjedisit ku jetojnë dhe veprojnë si dhe angazhimit të drejtpërdrejtë të tyre në fushata avokimi ATRC organizoi ligjerata me temë "Fëmijët në mbrojtje të Mjedisit", në 60 shkolla fillore të 30 komunave të Kosovës.

Nxënësit e përfshirë në ligjerata, me përkrahje nga ATRC, kanë zhvilluar më pas hulumtimin e opinionit me qytetarët lidhur me materialet promovuese të bizneseve dhe efektin e tyre negativ të krijuar si pasojë e

shpërndarjes së tyre. Gjithashtu, ATRC në bashkëpunim me drejtoritë e 60 shkollave fillore në Kosovë hartuan Kodin për Higjienë dhe kushte shëndetësore brenda dhe jashtë objektit shkollor. Kodi kishte për qëllim sigurimin e kushteve shëndetësore të nivelit sa më të lartë në hapësirat e shkollave si dhe të mbrojtjes së shëndetit të nxënësve.

Në këtë projekt nuk munguan as emisionet televizive të realizuara në pesë komuna të Kosovës, si: Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjiilan. Arsimitarët dhe nxënësit e klasave të pesta, pjesëmarrës në emisione prezantuan gjendjen mjedisore në shkolla si dhe angazhimet e tyre në këtë drejtim.





PRAKTIKA TE SUKSESSHME - KOMUNA FUNKSIONALE

Praktika të suksesshme-komuna funksionale, projekt ky i financuar nga fondet e USAID, kishte për qëllim ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile dhe zyrtareve komunal të tri komunave të reja: Gracanicë, Klllokot dhe Ranillugë dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkomunal në mes komunave të reja dhe atyre amë, përmes adaptimit dhe aplikimit të praktikave dhe procedurave të sukseshme nga komunat amë tek ato të reja.

Pas një sërë trajnimesh të mbajtura gjatë vitit 2010 me zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, ATRC këtë vit organizoi 9 vizita studimore në mes të komunave: Gracanicë-Prishtinë, Klllokot-Viti dhe Ranillugë-Kamenicë. Drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendeve komunale si dhe përfaqësues të shoqërisë civile të komunave të reja dhe atyre amë, gjatë këtyre vizitave, patën rastin të diskutojnë për problemet, sfidat dhe rezultatet e arritura në komuna si dhe të shkëmbejnë eksperiencën për procesin e hartimit, miratimit dhe të implementimit të rregulloreve komunale.

Pas vizitave studimore ATRC organizoi nga tri punëtori në secilën komunë, qëllimi i së cilave ishte facilitimi i procesit të hartimit të rregulloreve komunale. Në të tri këto komuna u formuan grupe punuese, të përbëra nga anëtarët e Kuvendit Komunal dhe përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët u angazhuan në hartimin dhe modifikimin e rregulloreve për transparencë.

Si rezultat i këtyre punësive Komuna e Gracanicës hartoi draft rregulloren për transparencë, kurse komuna e Klllokotit dhe e Ranillugut modifikuan rregulloren ekzistuese në harmoni me ligjet në fuqi. Rregulloret për transparencë në këto komuna u hartuan/modifikuan në përputhje me Ligjin për qasje në dokumentet publike si dhe me Rregulloren për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun.

DREJTËSIA DHE QYTETARËT



Kampanja “Drejtësia dhe qytetarët”, financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit – Zyra ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit, është një lëvizje që sjell së bashku qytetarët dhe grupet e shoqërisë civile me qëllim të identifikimit të çështjeve konkrete në sistemin e drejtësisë dhe promovimin e ndryshimeve përmes avokimit publik. Qëllimi i kampanjës është që të promovojmë një qeveri më të përgjegjshme dhe të rrisim përgjegjshmërinë e sistemit të drejtësisë ndaj nevojave të qytetarëve.

ATRC, në cilësinë e partnerit implementues, së bashku me Grupin e së Drejtës dhe Politikave Ndërkombëtare Publike (PILPG) gjatë këtij viti kanë organizuar 3 tryeza të ekspertëve të fushës së sundimit të ligjit. “Përforcimi i sundimit të ligjit në Kosovë”, “Sundimi i Ligjit - sfidat në implementim” dhe “Drejtësia në Drejtësi”?! Efiqasiteti në ndjekjen penale të korrupsionit - Mbikëqyrja efektive e akterëve të drejtësisë për parandalimin e korrupsionit, ishin temat kryesore të trajtuara në tryezat e organizuara.

Përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, përfaqësues të Organizatave të shoqërisë civile

dhe ekspertë të fushës së drejtësisë pjesëmarrës në tryeza, dhanë një pasqyrë të rëndësishme të problemeve në fushat e drejtësisë, reformës së sistemit dhe shqyrtimit të mënyrave për inkurajimin e qytetarëve të Kosovës për të marrë iniciativë në lidhje me sistemin e drejtësisë.

Me qëllim të zhvillimit të shkathtësive avokuese të organizatave të shoqërisë civile dhe krijimin e koalicioneve të nevojshme për punë efektive avokuese kundër dhunës në familje ATRC dhe PILPG realizuan edhe dy punëtori për Avokim dhe Dhunë në familje, të mbajtura në Prishtinë dhe Gjiilan dhe gjithashtu publikuan doracakun “Strategjitë e avokimit”. Doracaku përmban sqarime të detajuara rreth procesit të avokimit, hapave dhe strategji avokuese dhe këshilla praktike se si një organizatë joqeveritare ose edhe grup formal ose joformal avokues mund të fillojë një fushatë avokimi dhe të sigurojë rezultatin e synuar.

Doracaku “Strategjitë e avokimit”, mund të shkarkohet nga web faja e ATRC-së www.advocacy-center.org.

Peticioni kundër dhunës në familje

ATRC dhe PILPG në kuadër të kampanjës: “Drejtësia dhe qytetarët” organizuan aksionin për mbledhjen e nënshkrimeve nga qytetarët, kundër dhunës në familje. Ky aksion u organizua si pjesë e fushatës së iniciuar nga Agjencioni për Barazi Gjinore i Qeverisë së Kosovës. Nënshkrimet e mbledhura nga qytetarët i'u përcollën policisë së Kosovës, me kërkesën që viktimat e dhunës në familje të informohen për të drejtat dhe mundësitë që kanë në sistemin e drejtësisë.



SYNERGY PËR NDËRGJEGJËSIMIN E ENERGJISË NË SEE

ATRC në rolin e partnerit implementues për Kosovë dhe gjashtë organizata të gjashtë shteteve të rajonit kanë filluar implementimin e projektit Synergy for Energy Awareness in SEE Region. Përmes këtij projekti, organizatat partnere synojnë të bëjnë presion tek qeveritë e vendeve respektive që të orientojnë zhvillimin energjetik në vend sipas standardeve evropiane, duke i dhënë prioritet prodhimit të energjisë alternative ose me sa më pak ndotje në mjedis.

"Publikimi: "Më drejtë, Më pastër, Më sigurt" i përgaditur nga ATRC dhe organizatat partnere rajonale përfaqëson hapin e parë në atë që do të jetë fillimi i një fushate të gjatë dhe gjithnjë në rritje, përmes së cilës kërkohen më shumë zgjidhje të orientuara për problemet e energjisë në rajon. Bazuar në hulumtimet e zhvilluara, ATRC dhe organizatat partnere rajonale kanë rekomanduar qeveritë dhe institucionet publike të rajonit që:

- Të sigurohen mekanizma që do të lejojnë dhe inkurajojnë zgjidhje dhe vendime të orientuara drejt njerëzve në lidhje me strategjitë dhe planet energjetike;
- Të përmirësojnë dukshëm transparencën dhe qasjen në drejtësi në planifikimin dhe privatizimin e en-

ergjisë;

- T'i përqendrojnë politikat dhe prioritetet buxhetore në reduktimin e humbjeve dhe rritjen e efikasitetit në sistemin e energjisë nga prodhimi dhe transmetimi deri tek konsumi;
- Të sigurojnë masa për t'i ndihmuar qytetarët që t'i kompensojnë ndikimet e rritjes së çmimeve të energjisë, veçanërisht ata më të pambrojturit;
- Një sistem të qëndrueshëm, të besueshëm, të pavarur gjyqësor që është i aftë t'i trajtojë qoftë edhe mosmarrëveshjet më të ndjeshme, konfliktet e intereseve apo rastet e korrupsionit në mënyrë kompetente, efektive dhe me kohë, duke e rritur në këtë mënyrë besimin e investitorëve potencial në rajon;
- Të sigurojnë vlerësime të pavarura, më të mira të mundshme, të ndikimit të plotë (përfshirë kostot e jashtme, të tilla si sociale dhe mjedisore) të strategjive dhe projekteve të energjisë, të cilat duhet të jenë në dispozicion për publikun në kohën e duhur dhe në një formë lehtësisht të kuptueshme.

PROCESI I REGJISTRIMIT TË POPULLSISË, EKONOMIVE FAMILJARE DHE BANESAVE NË KOSOVË

Me qëllim të informimit të qytetarëve rreth procesit të regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë ATRC, në partneritet dhe me përkrahje nga UNOPS dhe Enti i Statistikave të Kosovës, ka organizuar 35 takime publike informative me qytetarë në 35 komuna të Kosovës.

Në këto takime të pranishëm ishin anëtarët e Komisioneve Komunale të regjistrimit, të cilët i informuan qytetarët më në detaje rreth procesit të regjistrimit. Theks të veçantë në këto takime iu dha rëndësisë së pjesëmarrjes së qytetarëve në këtë proces në mënyrë që procesi i regjistrimit të jetë i suksesshëm dhe njëkohësisht për të përmbushur standardet e Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e Kombeve të Bashkuara.

Me qëllim të informimit të publikut të gjerë rreth

këtij procesi ATRC, veç takimeve me qytetarë, organizoi edhe 5 debate televizive në 5 qytetet më të mëdha të Kosovës si dhe reklama në radiot lokale.



REFORMA ZGJEDHORE 2011

ATRC dhe Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave - KIPRED, në bashkëpunim dhe koordinim me Komisionin për Reformën Zgjedhore të Kuvendit të Kosovës, gjatë periudhës korrik - gusht organizuan takime informative me qytetarë.

Takimet u organizuan në 7 qendrat më të mëdha të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Gjilan dhe Ferizaj, në të cilat morën pjesë qytetarë të të gjitha komunave të Kosovës. Qëllimi i organizimit të takimeve publike ishte diskutimi rreth zgjedhjeve të kaluara në Kosovë si dhe nevoja e reformimit të sistemit zgjedhor.

Në të gjitha takimet e organizuara përveç anëtarëve të Komisionit për Reformën Zgjedhore, kanë marr pjesë edhe përfaqësues të partive politike, përfaqësues

nga Komisionet Komunale Zgjedhore, përfaqësues të organizatave joqeveritare, përfaqësues të mediave lokale, ekspertë dhe qytetarë.

Komisioni për Reformën zgjedhore, si organ prijës në këtë proces, në partneritet me ATRC dhe KIPRED, përmes takimeve informuese me grupe të interesit, ka diskutuar prioritetet për reformën zgjedhore në Kosovë, duke synuar që diskutimet dhe rekomandimet e dala në takimet e planifikuara t'i shërbejnë Komisionit për paturimin e dokumentit përmes përfshirjes ose kodifikimit të tyre në Reformën e re zgjedhore.

FUQIZIMI I ROLIT TË TË RINJËVE NË SKENËN POLITIKE NË KOSOVË

ATRC në partneritet me Organizatën Qendra për Hulumtime Kualitative dhe me përkrahje nga Fridrich Ebert Stiftung, ka mbajtur tri takime publike në Gjakovë, Gjilan dhe në Ferizaj për fuqizimin e rolit të të rinjve në skenën politike.

Përmes këtyre takimeve publike është synuar që me të rinjtë nga subjektet politike, anëtarët e forumeve rinore të partive politike, të rinjtë nga organizatat e

shoqërisë civile, zyrtarët për rini nga institucionet komunale, studentë, media lokale dhe anëtarë të qendrave rinore të diskutohet rreth pjesëmarrjes së të rinjve dhe rolit të tyre në skenën politike.

Njëkohësisht, gjatë këtyre takimeve është prezantuar edhe hulumtimi “Fuqizimi i rolit të të rinjve në skenën politike në Kosovë”.



ZGJERIMI I BE-SË, TRANSFORMIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT DHE ENERGJISË NË KOSOVË

ROLI I SHOQËRISË CIVILE

Forumi Mjedisor (FM) është një projekt i financuar nga Komisioni Evropian i dedikuar për të gjitha organizatat jo-qeveritare mjedisore të Ballkanit Perëndimor, të interesuara dhe të përfshira në procesin e zgjerimit të BE-së. Forumi synon të mbështesë OJQ-të në rolin e tyre aktiv dhe konstruktiv në procesin e zgjerimit.

Projekti bazohet në Dialogun e mëparshëm të OJQ-ve dhe Forumit të ri të OJQ-ve të cilat ishin të fokusuar në çështjet e shkëmbimit të informacionit dhe përmirësimit të transparencës në mes të OJQ-ve dhe Komisionit. Një nga qëllimet e forumit është që të zhvilloj kapacitetet e OJQ-ve avokuese për të krijuar një dialog konstruktiv me autoritetet kombëtare.

ATRC si anëtare e Forumit Mjedisor me seli në Bruksel (FM) këtë vit ka organizuar takimin përgatitor, për takimin e tretë vjetor të Forumit Mjedisor, me temën: Zgjerimi i BE-së, transformimi i sektorit të mjedisit dhe energjisë në Kosovë - roli i shoqërisë civile. Përfaqësues nga Ministria e Integritimeve Evropiane, Ministria e Energjisë, zyra e Ombudspersonit, agjensione qeveritare, profesorë të fakultetit, ekspertë të fushës dhe OJQ, pjesëmarrës në këtë takim diskutuan rreth kornizës legjislative dhe institucionale për energjinë efiçiente dhe burimet e energjisë së ri përtëritshme- transpozicionin e legjislacionit kombëtar me direktivat e BE-së, aplikimin e teknologjive të pastërta në prodhimin e energjisë nga linjiti – rasti "Kosova e re", mjedisin dhe transportin si dhe rolin e organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile në Kosovë.

Rekomandimet e dalura nga ky takim ishin:

- Të bëhet transpozimi i plotë i legjislacionit me direktivat e BE-së për EE dhe BRE si dhe të kompletet legjislacioni sekondar për këtë fushë;
- Të punohet në forcimin institucional për EE dhe BRE, qoftë përmes Themelimit të Agjencisë së Kosovës për efiçencë të energjisë ose edhe përmes ngritjes së zyrave komunale për energji;
- Të koordinohen aktivitetet rreth efiçencës së energjisë në mes institucioneve përkatëse (si MEM, MMPH, komunat, donatorët dhe OJQ-të);
- Të iniciohet themelimi i Fondit për efiçencë të energjisë dhe burime të ripërtëritshme të energjisë;
- Të punohet në ngritjen e kapaciteteve humane në fushën e EE (Licencimi i auditorëve të energjisë, Trajnimi i trajnerëve për EE; Trajnimi i zyrtarëve të ko-

munave për EE);

- Të mbështeten edhe studime dhe hulumtime tjera për potencialet alternative për përfitime të energjisë (ujit, erës, biomasës solare, mbeturinave dhe gjeo-termale), me qëllim të krijimit të bazës së të dhënave për potencialet e energjisë alternative;
- Të hartohen kurikula për programe edukative në shkollat fillore dhe të mesme si dhe programe edukative në fakultete për EE dhe BRE.
- Të vazhdohet me mbështetjen e projekteve për zbatim të EE si në ndërtesat publike, në ndriçimin publik, në ngrohje qendrore etj;
- Të punohet edhe më shumë në vetëdijësimin e komunitetit për EE dhe BRE (përmes projekteve, broshurave, mediave, etj).

PERCEPTIMI I BARAZISË GJINORE NË 8 KOMUNA TË KOSOVËS

ATRC me përkrahje nga Inter-Cooperation ka zhvilluar një sërë aktivitetesh në 8 komuna të Kosovës: Kamenicë, Novobërdë, Kllokot, Hani i Elezit, Kaçanik, Ranillugë, Viti dhe Shtërpce, të përqendruara në vlerësimin e gjendjes në këto komuna në implementimin e ligjit për barazi gjinore.

Përmes intervistave me zyrtaret për barazi gjinore ATRC ka zhvilluar një raport rreth implementimit të ligjit për barazi gjinore, rezultatet e së cilit janë pjesë e hulumtimit “Perceptimi i barazisë gjinore në 8 komuna të Kosovës” i realizuar nga Inter-cooperation. Në kon-

ferencën e organizuar nga Inter-cooperation me zyrtaret për barazi gjinore, drejtorët dhe zyrtarët komunal është diskutuar dhe analizuar më në detaje gjendja e përgjithshme në komunat e lartpërmendura në fushën e respektimit të barazisë gjinore.

ATRC gjithashtu përmes një punëtorie tre ditore ka asistuar komunat e lartpërmendura në zhvillimin e draft projekteve në fushën e barazisë gjinore dhe të infrastrukturës.



ATRC CERTIFIKOHET NGA MINISTRIA E DREJTËSISË PËR KONTRIBUTIN E DHËNË NË PROCESIN E NDËRMJETËSIMIT

Si rezultat i trajnimit dyjavor të organizuar nga ATRC dhe organizata “CCSP”, për 15 ndërmjetësuesit e regjionit të Prishtinës dhe aftësimin e tyre për të qenë ndërmjetësues sipas përkufizimeve dhe përcaktimeve Ligjore, Ministria e Drejtësisë, përkatësisht Ministri i Drejtësisë me rastin e licencimit të Ndërmjetësuesve i ka ndarë certifikatë ATRC-së, me motivacionin: Për kontributin dhe ndihmën e ofruar në zhvillimin e procesit të ndërmjetësimit në Republikën e Kosovës”.

Sipas Ligjit për Ndërmjetësim, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në 2008, ndërmjetësuesit do të licencohen nga Ministria e Drejtësisë dhe më pas do të angazhohen drejtpërdrejt në procesin e ndërmjetësimit në rastet të cilat referohen nga gjykatat ose edhe drejtpërdrejt, si një nga mënyrat më të shpejta në zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara në gjykata.



ATRC CERTIFIKOHET NGA USAID- INITIATING POSITIVE CHANGE



Këtë vit ATRC ka marr certifikatë mirënjohje nga Agjensioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)-Initiating Positive Change, për punën e çmuar si partner në kuadër të projektit “Praktika të suksesshme-Komuna funksionale”.

ATRC ANËTARE E GRUPEVE PUNUESE

Me kërkesë të Agjencionit të Pyjeve të Kosovës, respektivisht të Drejtorisë për: MKE, Gjueti dhe Eko-Turizëm të APK-së, ATRC dhe APK kanë diskutuar mundësitë e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve në mes dy palëve. Dy anëtarë të Rrjetit BELLS për Kosovë, të udhëhequr nga ATRC janë propozuar anëtarë të grupit përkrahës në kuadër të projektit të APK-së për ruajtjen dhe kultivimin e parqeve natyrore.

Me propozim dhe vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së, drejtori i ATRC-së Kushtrim Kaloshi është emëruar anëtar i grupit punues qeveritar për shqyrtimin e Projektligjit për Nisma Legjislative, bartëse e të cilit ka qenë Zyra e Kryeministrit.



PROGRAMI PËR INFORMIM

Programi i ATRC-së për informim, mbështet shkëmbimin e informatave ndërmjet OJQ-ve, institucioneve qeveritare, donatorëve, zyrtarëve dhe qytetarëve. Këtë e realizon përmes diskutimeve publike, konferencave, prezantimeve të donatorëve, publikimeve dhe uebfaqes së ATRC-së.

Buletini "Avokuesi"

ATRC vazhdon me publikimin e buletinit elektronik "Avokuesi", i cili përmban aktivitetet kryesore të zhvilluara gjatë periudhës tremujore. "Avokuesi" përcillet në mënyrë elektronike tek OJQ-të, mediat, institucionet qeveritare dhe lokale, partnerët dhe përkrahësit potencial brenda dhe jashtë Kosovës. "Avokuesi" mund të shkarkohet nga web faqja e ATRC: www.advocacy-center.org.

Biblioteka

Biblioteka e ATRC-së posedon më shumë se 1.060 tituj librash, raportesh dhe materiale të tjera në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe për avokim, shoqëri civile, lidhshmëri, të drejtat e njeriut, vetëdijësim gjinor, etj. Për më shumë informata mund të hyni në web faqen e ATRC: www.advocacy-center.org.

Ueb faqja e ATRC

ATRC pasuron uebfaqen me informacione të reja, duke e bërë atë më të përshtatshme për shfrytëzuesit në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe. Në vitin 2011, uebfaqja është vizituar 20.864 herë.

SHTYPI PËR ATRC-NË

me befasi e duhet të hin gjashhtë me burg për ish-teleshkriarë dhe asnjëri me madh i krimin e detyrës are", tha Hasan Preteni

Prokuroria kërkon specializim për hetimin e korrupsionit
Prokurori kundër korrupsionit, Lulëzim Sylejmani nga Prokuroria e Mungon guximi

Ekspertët e pranishëm në këtë tryezë kërkuan që kur të merren urdhrat e arrestimeve duhet të ketë siguri për prokurorët e familjet e tyre. Ndërsa për korrupsionin e vogël deri në 1000 euro thanë se e kryejnë pa problem e pasurisë milionëshe të paljustifikuar, urdhrat për konfiskimin e pasurisë milionëshe të shoqërisë civile për Qëllimi i fushatës avokuese është inkurajimi i shoqërisë civile për të marrë informata pozitive në fushat e caktuara në sektorin e drejtësisë në Kosovë.

Gjyqësori në situatë dëshpër
Gjyqësori në situatë dëshpër në sistemin e drejtësisë në Kosovë, gjatë një tryeze të ekspozitës së ATRC-së në Prishtinë, ndërkohë që prokurorët kanë arsyetuar mungesën e gjyqsorit të shkarkuar vullnetisht në pritje për ndryshimin e situatës së ndërtimit të drejtësisë në Kosovë.

Në ujërat e korrupsionit notojnë pa frikë "peshqit e mëdhenj!"
Për luftën kundër korrupsionit më shumë po flitet sesa po merret ndonjë veprim konkret.

Qeveria, prioriteti shtundim i ligjit
Qeveria, prioriteti shtundim i ligjit

RAPORTI FINANCIAR



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Bordit të Drejtorëve të Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

Ne kemi audituar pasqyrat përcjellëse financiare të Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC-së, të cilat përfshijnë bilancin e gjendjes më 31 Dhjetor 2011, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, pasqyrën e rrjedhës së parave për vitin që u mbyll, dhe shënimet tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm, në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrime apo pasaktësi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme me rrethanat.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim të marrjes së provave të auditimi për vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të ekzistencës së gabimeve në pasqyrat financiare, qofshin ato rezultat i mashtrimeve apo pasaktësive. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë, ofrojnë bazë të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të ATRC-së më 31 dhjetor 2011, dhe rezultatin e aktivitetit të saj për fundin e vitit, në përputhje me politikat kontabël të aprovuara në Republikën e Kosovës.

Armend Osaj – Auditor ligjor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtinë, Kosovë
Mars 2012



Raportin e Auditimit mund ta shkarkoni nga web faqja zyrtare e ATRC-se: www.advocacy-center.org



BOTIMET E ATRC-SË

Doracak për Strategjitë e avokimit

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve avokuese të organizatave joqeveritare dhe qytetarëve në përgjithësi, në kuadër të kampanjës: “Drejtësia dhe qytetarët”, ATRC dhe PILPG kanë përgatitur dhe publikuar dokumentin: “Doracak për Strategjitë e avokimit”. Doracaku i është shpërndarë falas organizatave, grupeve formale dhe joformale avokuese, institucioneve publike etj. Dokumenti përmban sqarime të detajuara rreth procesit të avokimit, hapave dhe strategjive avokuese dhe këshilla praktike se si një organizatë joqeveritare, grup formal ose joformal mund të fillojnë një fushatë avokimi dhe të sigurojnë rezultatin e synuar.

“Udhëzues për procesin e buxhetimit me pjesëmarrje”

Në kuadër të projektit “Zgjidhja e konfliktit social”, të financuar nga Olof Palme International Center, ATRC ka publikuar udhëzuesin për procesin e buxhetimit me pjesëmarrje. Udhëzuesi përmban shembuj dhe rekomandime për komunat, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët rreth përfshirjes së qyte-

tarëve në vendimmarrje, që nga faza e planifikimit të buxhetit komunal deri në implementimin e tij.

Udhëzuesi i është shpërndarë falas zyrtarëve komunal dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Raport rreth perceptimit të barazisë gjinore në 8 Komuna të Kosovës

ATRC ka zhvilluar një raport rreth implementimit të ligjit për barazi gjinore në 8 komuna të Kosovës: Kamenicë, Novobërdë, Kllokot, Hani i Elezit, Kaçanik, Ranillugë, Viti dhe Shtërpce, rezultatet e së cilës janë pjesë e hulumtimit “Perceptimi i barazisë gjinore në 8 komuna të Kosovës” të realizuar nga Inter-cooperation.

Raporti vjetor 2010

ATRC ka botuar raportin përmbledhës të punës së saj vjetore për vitin 2010. Ky botim ofron një pasqyrë të aktiviteteve dhe të arritjeve kryesore të ATRC-së gjatë vitit 2010.

Të gjitha publikimet e ATRC mund të mirren në zyret e ATRC ose të shkarkohen nga web faqja e ATRC: www.advocacy-center.org.

BORDI I ATRC-SË

KRESHNIK BERISHA

Kryetar i Bordit

ADRIANA KABASHI

Nënkryetare e Bordit

VJOSA MULLATAHIRI

Anëtare e Bordit

Prof. Dr. ISA ELEZAJ

Anëtar Bordi

NAIM RASHITI

Anëtar Bordi

PERSONELI I ATRC-SË

Drejtor Ekzekutiv

Kushtrim Kaloshi

kushtrimk@advocacy-center.org

Drejtor i Programit

Donika Podrimja

donika@advocacy-center.org

Menaxher i Financave dhe Administratës

Gani Asllani

gani@advocacy-center.org

Menaxhere e Programit të Trajnimeve dhe
Konsulencave

Nora Susuri

nora@advocacy-center.org

Koordinatorë e Projektit

Sanije Goxhufi

sanije@advocacy-center.org

Asistente e Projektit

Bojana Delibasic

bojana@advocacy-center.org

Koordinator i projektit

Astrit Rexhaj

astrit@advocacy-center.org

Koordinatorë e Ekipit për Monitorimin
e të Kthyerve

Emine Emini

emine_e@advocacy-center.org

Monitoruese

Magbule Pllana

magbule@advocacy-center.org

Monitorues

Hysen Hamzaj

hysen@advocacy-center.org

Monitorues

Zaid Kulinxha

zaid@advocacy-center.org

TI & Administratë

Arsim Kosumi

arsim@advocacy-center.org

Asistente Administrative

Jehona Tmava

jehona@advocacy-center.org

Praktikant/e

Landër Islami

Edona Januzi

Fjollë Metaj

internship@advocacy-center.org



Ky raport u mundesua nga kontributi i stafit të ATRC-së, përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e ATRC-së. Të gjitha të drejtat e rezervuara © 2011, ATRC-Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim, Prishtinë - Kosovë Raporti Vjetor 2011 i ATRC-së është përgaditur nga stafi i ATRC-së dhe dizajnuar nga Arsim Kosumi.

CONTENTS

CONTENTS

A Letter from the Executive Director.....	3
About ATRC	4
Mission	5
Partners	6
Supporters	7
Program for development of capacities	8
Individual consultancies	9
Program for management of grants	10
Advocacy program	11
Monitoring the process of the return of displaced persons from third countries.....	12
Regional environmental movement “BELLS”.....	13
Social conflict resolution	14
Young ambassadors for the protection of environment	15
Successful practices – functional municipalities	16
Justice and the people	17
